

VENDIM
Nr. 122, datë 3.3.2021

PËR MIRATIMIN E KATEGORISË SË NDËRTESAVE, QË PËRJASHTOHEN
NGA LIGJI NR. 116/2016, “PËR PERFORMANCËN E ENERGJISË SË
NDËRTESAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 4, të ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshihen nga zbatimi i ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, objektet që do të ndërtohen në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, dhe ndërtimi i të cilave miratohet nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit dhe Agjencia për Efiçencën e Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe